

Emri i Lëndës : Menaxhim							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
EMS 112	B	Pranverë	3.00	1.00	0.00	3.50	5.00
<b>Lektori</b>		Elda Dollija, PhD					
<b>Asistenti</b>							
<b>Gjuha e kursit</b>		Anglisht					
<b>Niveli i lëndës</b>		Bachelor					
<b>Përshkrimi</b>		Lënda Menaxhim ka si qëllim kryesor të pajisë studentët e vitit të parë të Programit të studimit Informatikë Ekonomike dhe finance Kontabilitet me njohuritë bazë më bashkëkohore në fushën e menaxhimit të organizatave (publike, private dhe jofitimprurëse). Programi i modulit është konceptuar si një tërësi njohurish themelore, të cilat do të thellohen më tej nga studentët në vitet e mëvonshme, në fushat e tjera. Duke u bazuar në këtë mënyrë konceptuale programi përfshin njohuri të domosdoshme mbi konceptin e menaxhimit dhe rolin e tij në shoqëri, paraqitjen e sfondit historik të zhvillimit të shkencës menaxheriale, shqyrtimin e raportit menaxher- organizatë, identifikimin dhe sqarimin e funksioneve bazë menaxheriale: planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin.					
<b>Objektivat</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• T'i pajisë studentët me njohuritë bazë mbi rolet dhe funksionet e një menaxheri në organizatat e biznesit.</li> <li>• Të analizojë në mënyrë të detajuar mjedisin në të cilin operojnë organizatat me qëllim që vendimet menaxheriale të jenë me një nivel të lartë efektiviteti menaxherial.</li> <li>• Të orientojë studentët që të përdorin në mënyrë racionale teknikat ndihmëse në funksion të përmirësimit të cilësisë së menaxhimit.</li> <li>• Të aftësojë studentët që njohuritë e fituara gjatë këtij kursi t'i përdorë në funksion të formimit të tij dhe njëkohësisht të orientohej me sukses në praktikat e biznesit.</li> </ul>					
<b>Konceptet Kryesore</b>		Menaxhim, mjedis, planifikim, prognozim, organizim, strukturë, marrëdhënie, autoritet, delegim, centralizim, decentralizim, departamentizim, udhëheqje, stile, motivim, burime njerëzore, kontroll, operacione.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Menaxheret dhe Menaxhimi Në këtë temë, studentët do të njihen me këto çështje: kush janë menaxherët dhe ku punojnë ato? Cfarë është menaxhimi? Përse të studiojmë menaxhim? Cilat janë 4 funksionet e menaxhimit, rolet e menaxherit dhe aftësitë menaxheriale? Faktorët që po ridimensionojnë menaxhimin. (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 24-47)						
2	Zhvillimi historik i shkencës së menaxhimit Në këtë temë, studentët do të njihen me këto çështje: Lindja e shkollave të menaxhimit, Shkollat klasike, Shkolla e sjelljes, Shkolla sasiore, Teoritë moderne të menaxhimit, Perspektiva të reja të menaxhimit. (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 49-56)						
3	Çfarë është Ambjenti i Jashtëm dhe Kultura Organizative? Në këtë temë, studentët do të njihen me këto çështje: çfarë është ambienti i jashtëm dhe përse është i rëndësishëm ai? Çfarë roli luajnë të dhënat demografike? Si ndikon kultura organizative në punën e menaxherëve dhe punonjësve? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 56-80)						
4	Procesi i vendimmarrjes Në këtë kapitull studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Përcaktimi i procesit të vendimmarrjes. Shpjegoni tre qasjet e vendimmarrjes. Përcaktoni kushtet në të cilat menaxherët marrin vendime (siguria, rreziku dhe pasiguria). Si i marrin vendimet grupet. Problemet bashkëkohore me të cilat përballen menaxherët gjatë marrjes së vendimeve sot. (Robins, Coulter & DeCenzo f. 110-141)						

<b>5</b>	Metodat sasiore të vendimmarrjes Në këtë kapitull studentët do të njihen me këto tema: Matrica e rezultateve (metoda maksimale, maksimumi, minimaks), Pema e vendimeve, Analiza e pikës kritike, Analiza e raporteve, Programimi linear. (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 141-151)
<b>6</b>	Bazat e planifikimit Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Çfarë është Planifikimi dhe pse menaxherët duhet të planifikojnë? Pse menaxherët duhet të dinë për menaxhimin strategjik? Pse menaxherët vendosin qëllime dhe plane? Llojet e qëllimeve dhe planeve. Me çfarë çështjesh bashkëkohore përballen menaxherët sot se sa planifikimi (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 152-182)
<b>7</b>	Struktura organizative Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Cilat janë gjashtë elementet kryesore në struktues organizative (Specializimi, Departamentalizimi, Autoriteti, Përgjegjësia, Kontrolli, Centralizimi, Decentralizimi, Formalizimi). Cilat variabla të rastësishëm ndikojnë në zgjedhjen strukturore? Strukturat e ndryshme organizative. Sfidat e strukturave organizative. (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 182-218)
<b>8</b>	Mid-tearm
<b>9</b>	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Çfarë është procesi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe çfarë ndikon në të? Pse menaxherët identifikojnë dhe përzgjedhin punonjësit kompetent? Si u sigurohen punonjësve aftësitë dhe njohuritë e nevojshme? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 218-254)
<b>10</b>	Leader dhe Leadership, Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Cfare cilesish dhe karakteristikash kane leader-at?cfare sjelljesh kane leader-at? Teorite e kontigjences dhe torite e sotme te leadership-it (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 385-410)
<b>11</b>	Menaxhimi i ndryshimit dhe inovacionit Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Çfarë është ndryshimi dhe si merren me të menaxherët? Si e menaxhojnë menaxherët rezistencën ndaj ndryshimit? Çfarë reagimesh kanë punonjësit ndaj ndryshimit organizativ? Si mund të inkurajojnë menaxherët ndryshimet organizative? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 258-286)
<b>12</b>	Motivimi dhe shpërblimi i punonjësve Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Çfarë është motivimi? Katër teoritë e hershme të motivimit: Teoria e Hierarkisë së Nevojave të Maslow, Teoria X dhe Y e McGregor, Teoria e Dy Faktorëve të Herzberg, Teoria e Tre Nevojave të McClelands. Si e shpjegojnë teoritë bashkëkohore motivimin? Me cilat çështje aktuale të motivimit përballen menaxherët sot? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 350-382)
<b>13</b>	Menaxhimi i komunikimit dhe informacionit Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Si komunikojnë menaxherët në mënyrë efektive? Teknologjia dhe komunikimi menaxherial. Me cilat probleme komunikimi përballen menaxherët sot? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 414-442)
<b>14</b>	Bazat e kontrollit. Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Çfarë është kontrolli dhe pse është i rëndësishëm? Çfarë ndodh kur menaxherët kontrollojnë? Çfarë duhet të kontrollojnë menaxherët? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 442-472)
<b>15</b>	Menaxhimi i Operacioneve Në këtë kapitull, studentët do të njihen me temat e mëposhtme: Pse është i rëndësishëm për Organizatat Administrimi i Operacioneve? Çfarë është menaxhimi i zinxhirit të vlerës dhe pse është i rëndësishëm? Me cilat çështje bashkëkohore përballen menaxherët në menaxhimin e operacioneve? (Robins, Coulter & DeCenzo fq. 472-503)
<b>16</b>	Provim Final

<b>Parakushtet</b>	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
<b>Literatura</b>	• Stephen P Robbins, Mary Coulter & David De Cenzo "Foundation of Management", Eleventh edition, 2020, Pearson
<b>Referenca të tjera</b>	• Gerald A Cole, Phil Kelly, "Management Theory and Practice", 8th Edition, 2016, Cengage

### Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

<b>1</b>	Studentët do të jenë të aftë të evidentojnë rëndësinë e menaxhimit të organizatave të biznesit dhe jo vetëm
<b>2</b>	Studentët do të pajisen me njohuri për rolin e menaxherit në organizatë
<b>3</b>	Studentët do të realizojnë analiza kritike të problemeve dhe sfidave bashkëkohore menaxheriale
<b>4</b>	Studentët do të evidentojnë funksionet kryesore menaxheriale si planifikimi, organizimi, udhëheqja dhe kontrolli
<b>5</b>	Studentët do të përmirësojnë aftësitë e prezantimit të punëve individuale dhe në grup

### Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

<b>Notat e Ndërmjetme</b>	<b>Sasia</b>	<b>Përqindja</b>
Gjysmë finale	1	30
Kuize	0	0
Projekte	1	20
Projekte semestrale	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	10
<b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>		<b>60</b>
<b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>		<b>40</b>
<b>Total</b>		<b>100</b>

### Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

<b>Aktivitetet</b>	<b>Sasia</b>	<b>Kohëzgjatja (orë)</b>	<b>Ngarkesa Totale (orë)</b>
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	1	8	8
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	15	15
Të tjera	0	0	0
<b>Ngarkesa totale e orëve</b>			<b>125</b>
<b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>			<b>5.00</b>
<b>ECTS</b>			<b>5.00</b>